

BANKA E SHQIPËRISË

UDHËZUES

PËR RISTRUKTURIMIN
E KREDIVE TË BIZNESIT

Tetor 2013

PËRMBAJTJA

1.	<i>HYRJE</i>	5	
1.1.	<i>Përkufizime</i>	5	
1.2.	<i>Të përgjithshme</i>	6	
1.3.	<i>Përfitimet e ristrukurimit të kredisë</i>	6	
2.	<i>OBJEKTIVAT DHE FUSHA E VEPRIMIT</i>	8	
3.	<i>PARIMET DHE KOMENTET</i>	10	
	<i>Parimi 1</i>	<i>Ristrukurimi i borxhit është lehtësim, por jo një e drejtë</i>	10
	<i>Parimi 2</i>	<i>Mirëbesimi</i>	11
	<i>Parimi 3</i>	<i>Përqasja e unifikuar</i>	12
	<i>Parimi 4</i>	<i>Negocimi me huamarrësin</i>	13
	<i>Parimi 5</i>	<i>Periudha e moratoriumit</i>	14
	<i>Parimi 6</i>	<i>Gjetja e burimeve të reja</i>	15
	<i>Parimi 7</i>	<i>Ndërmarrja e veprimeve gjatë periudhës së moratoriumit</i>	16
	<i>Parimi 8</i>	<i>Premtimet e huamarrësit për huadhënësit gjatë periudhës së moratoriumit</i>	16
	<i>Parimi 9</i>	<i>Transparenca e plotë e huamarrësit gjatë periudhës së moratoriumit dhe marrëdhënieve të reja kontraktuale</i>	17
	<i>Parimi 10</i>	<i>Konfidencialiteti i informacionit</i>	18
	<i>Parimi 11</i>	<i>Ndërtimi i planit të ristrukurimit të kredisë</i>	18
	<i>Parimi 12</i>	<i>Propozimet e bëra korrespondojnë me të drejtat e palëve</i>	19

1. HYRJJE

1.1 PËRKUFIZIME

- a) *“Ristrukturimi i kredisë”* – është lehtësimi/et që banka bën për huamarrësin/it për shkak të vështirësive financiare të tyre të shkaktuara nga arsye ekonomike ose ligjore, të cilat nuk bëhen nga banka në asnjë rast tjetër dhe përfshijnë në përgjithësi:
- i) *lehtësimet e bëra në kushtet e kredisë nëpërmjet ndryshimit të një ose disa kushteve të kontratës (duke përfshirë ndryshimin e produktit dhe kapitalizimin e interesit), të cilat lidhen kryesisht me afatin, kryegjënë dhe normën e interesit;*
 - ii) *marrjen (përdorimin) e kolateralit apo pasurive të tjera për shlyerjen e pjeshme të kredisë;*
 - iii) *zëvendësimin e huamarrësit fillestar ose përfshirjen e një huamarrësi shtesë.*
- b) *“Huamarrës” (debitorë dhe/ose bashkëdebitorë)* - janë personat fizikë ose juridikë, të cilët kanë marrë kredi biznesi për aktivitetin e tyre të biznesit.
- c) *“Huadhënës”* - janë bankat dhe institucionet financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë për dhënie të kredive.
- d) *“Moratorium”* - është ndërprerja e përkohshme e veprimeve ligjore kundrejt palës tjetër.

1.2 TË PËRGJITHSHME

Koment:

Me vështirësi financiare nënkuptohet pamundësia e huamarrësit për të respektuar në kohë detyrimet e kontratës së nënshkruar me huadhënësin, por që huadhënësi gjykon se nëpërmjet procesit të ristrukturimit huamarrësi do të jetë në gjendje të shlyejë detyrimet e tij sipas kushteve të reja të vendosura.

Pala që kryen biznes e ndodhur në vështirësi financiare (në vijim - huamarrësi) dhe huadhënësi (institucionet financiare) mund të zgjedhin të hyjnë në një marrëveshje, ku palët bien dakord reciprokisht mbi ristrukturimin e kredisë, sipas të cilës të dyja palët arrijnë një marrëveshje për ndryshimin e kushteve të shlyerjes së kredisë, në mënyrë të tillë që lejon huamarrësin të vazhdojë veprimtarinë e tij dhe njëkohësisht të shlyejë detyrimet ndaj huadhënësit.

Si parim ligjor, ristrukturimi i kredisë ndodh në momentin kur shoqëritë kanë vështirësi financiare. Kohët e fundit, ka pasur një tendencë në rritje të mbledhjes së pagesave të kredive që kanë shfaqur vështirësi pa shkuar deri në procedurat formale të falimentimit të huamarrësve, nëpërmjet procesit të ristrukturimit në kohë të kredive të huamarrësve bashkëpunues.

1.3 PËRFITIMET E RISTRUKTURIMIT TË KREDISË

Përgjithësisht, përfitimet e ristrukturimit janë:

- lejon kompanitë në vështirësi financiare të zgjedhin të vazhdojnë veprimtarinë dhe të kapërcejnë vështirësitë;
- i jep mundësi institucioneve financiare dhe huadhënësve të tjerë të zvogëlojnë humbjet;
- krijon mundësi për shmangien e ndikimeve negative sociale dhe ekonomike, të cilat mund të lindin si rrjedhojë e falimentimit të kompanive;
- shmang procesin gjyqësor, i cili mund të kërkojë kohë deri në përfundimin e tij, si dhe rrit efikasitetin e mbledhjes së kredive;
- është në favor të palëve të tjera të interesuara (klientët, punonjësit, furnitorët dhe investuesit), sepse kompanitë e përfshira në ristrukturimin e kredisë mund të vazhdojnë biznesin e tyre;
- ndihmon në rritjen e besimit të bizneseve ndaj huadhënësve, veçanërisht kur procesi është i barabartë dhe transparent.

2. OBJEKTIVAT DHE FUSHA E VEPRIMIT

Qëllimi i këtij dokumenti është t'i ofrojë shoqërive të biznesit, huadhënësve dhe institucioneve përkatëse shtetërore informacion mbi parimet dhe udhëzimet në lidhje me procesin e ristrukturimit të kredive. Parimet dhe udhëzimet janë bazuar në shembujt e praktikave më të mira ndërkombëtare.

Objektivi i parimeve në vijim është vendosja e orientimeve mbi të cilat duhet të bazohet procesi i ristrukturimit të kredisë, në mënyrë që huamarrësit në vështirësi financiare të kenë mundësinë të përmbushin detyrimet kontraktuale, me qëllim zhvillimin normal të veprimtarisë së tyre të biznesit, si dhe të parandalojnë sa më shumë të jetë e mundur ekzekutimin e kolateralit që zakonisht përfshin një procedurë të gjatë dhe të kushtueshme për të dyja palët.

Këto parime nuk ndikojnë efektet e detyrueshme të standardeve ligjore apo zbatimin e tyre. Çdo huadhënës ka politikën e tij të ristrukturimit, bazuar në karakteristikat e portofolit të kredisë për biznes dhe në strategjinë e tij. Duhet theksuar fakti se ristrukturimi është një e drejtë e huadhënësit dhe jo një detyrim për të, si dhe një mundësi për huamarrësin dhe jo një detyrim për të. Kjo zakonisht, gjykohet si një zgjidhje e përshtatshme në rast të vështirësive financiare të këtij të fundit.

Parimet e mëposhtme do të zbatohen vetëm për huamarrësit, të cilët janë në një marrëdhënie kredie dhe përballen me vështirësi financiare, duke mos arritur të përmbushin detyrimet e përcaktuara në marrëveshjen e kredisë.

Është e nevojshme që huadhënësi të vlerësojë me kujdes nevojën për bashkëpunim me huamarrësin që përballet me vështirësi financiare, si dhe të ndjekë parimet e mëposhtme gjatë procesit të ristrukturimit të kredive.

Në përgjithësi, ky dokument shërben si mjet për një komunikim të hapur midis huamarrësit dhe huadhënësit, me fokus të veçantë mbi huamarrësin, i cili vlerëson se ka hapësirë për të përmirësuar marrëdhëniet financiare me huadhënësin, duke treguar në të njëjtën kohë një angazhim të plotë për shlyerjen e detyrimeve të tij. Si i tillë, dokumenti është konceptuar në formën e një udhëzuesi, duke shërbyer njëkohësisht edhe si një mjet edukues. Ndërsa për huadhënësin, do të shërbejë si një udhëzues për të gjitha hapat që përfshin procesi i ristrukturimit të kredisë.

Dokumentu është hartuar në formën e parimeve mbi të cilat duhet të mbështeten të dyja palët kur hyjnë në një marrëveshje ristrukturimi.

Për më tepër, këto parime shërbejnë si për procesin e ristrukturimit, ashtu edhe për të gjithë periudhën e marrëdhënies midis palëve. Gjithashtu, ajo merr në konsideratë të gjitha kombinimet e mundshme për marrëdhënie të tilla si: një huadhënës dhe një ose më shumë huamarrës, një huamarrës dhe një ose më shumë huadhënës apo kombinimi i të dyjave.

3. PARIMET DHE KOMENTET

PARIMI 1 RISTRUKTURIMI I BORXHIT ËSHTË LEHTËSIM, POR JO NJË E DREJTË

Të gjithë huamarrësit janë të detyruar të paguajnë kreditë e tyre sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në kontratën e kredisë të nënshkruar me huadhënësin. Ristrukturimi i kredisë përfaqëson një lëshim në interes të huamarrësit dhe mund të realizohet vetëm në qoftë se problemet financiare të huamarrësit janë të përkohshme dhe të zgjidhshme, në mënyrë që biznesi të vazhdojë veprimtarinë, si dhe të arrijë të paguajë detyrimet financiare sipas marrëveshjes së re që do të nënshkruajë me bankën.

Koment:

Të gjithë huamarrësit janë të detyruar të paguajnë kreditë e tyre në përputhje me kushtet kontraktuale. Prandaj, huamarrësit duhet të diskutojnë me huadhënësit e tyre problemet në momentin që ato shfaqen, në vend që të presin të ndodhë pamundësia e pagesës.

Ristrukturimi i kredisë është një mënyrë për të zgjidhur problemet e një shoqërie, e cila është duke u përballur me probleme financiare, pa iu drejtuar procedurës së falimentimit dhe procesit gjyqësor. Megjithatë, ristrukturimi i kredisë duhet të bëhet atëherë kur ekzistojnë kushtet që e lejojnë huamarrësin të ofrojë zgjidhje të problemeve financiare, të cilat do ta lejojnë biznesin të paguajë detyrimet financiare dhe të vazhdojë veprimtarinë e tij në afat të gjatë. Në qoftë se këto kushte nuk ekzistojnë, atëherë huadhënësit duhet të shkojnë drejt procesit të ekzekutimit të kolateraleve, i cili mund të çojë deri në falimentimin e huamarrësit.

Një nga parimet bazë të ristrukturimit të kredisë është parimi i veprimit të vullnetshëm. Ky parim përshkruan lirinë e krijimit të marrëdhënieve ligjore në funksion dhe zbatim të tij, si dhe në zgjedhjen e personave me të cilët do të hyjnë në marrëdhënie juridike. Palët mund të hyjnë në çdo transaksion dhe është e rëndësishme që të gjitha palët të marrin pjesë në negociata në mënyrë që të arrijnë në një zgjidhje të përshtatshme.

Ristrukturimi i detyrimeve të huamarrësit nuk duhet të shihet si një e drejtë e tij. Në mënyrë të ngjashme, huadhënësit nuk mund të perceptojnë se ata kanë të drejtë t'i kërkojnë huamarrësit të hyjnë në negociata për ristrukturim. Të drejtat e palëve lindin nga kontrata. Këto të drejta përfshijnë të drejtën e huadhënësit të paraqesë një kërkesë në gjykatë kundër huamarrësit për mosplotësimin e detyrimeve të tij, dhe të kërkojë ekzekutimin e kolateralit të

lënë si garanci. Gjithashtu, ndër të drejtat e palëve është edhe e drejta e huadhënësit të nisë procedurat e falimentimit në gjykatë.

Në lidhje me këtë parim, duhet theksuar se huadhënësi duhet të respektojë parimet e drejtësisë, të cilat nënkuptojnë mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshme të palëve. Për t'u siguruar që të drejtat e tyre janë të garantuara, palët mund të fillojnë të negociojnë në mirëbesim në mënyrë që huamarrësit të jenë të aftë të vazhdojnë biznesin dhe në të njëjtën kohë, të shlyejnë detyrimet ndaj huadhënësve.

Për më tepër, është e rëndësishme të theksohet se negociatat fillestare për ristrukturimin e kredisë janë zgjedhje e palëve-huamarrësit dhe huadhënësit.

Duke pasur parasysh këtë fakt, nëse huamarrësi kërkon të nisë ristrukturimin e kredisë, është huadhënësi i cili ka ende të drejtën të kërkojë përmbushjen e detyrimeve aktuale.

PARIMI 2 MIRËBESIMI

Negociatat midis huamarrësit dhe huadhënësit duhet të zhvillohen në mirëbesim të plotë në mënyrë që të arrihet në gjetjen e një zgjidhjeje të përshtatshme dhe të qëndrueshme.

Koment:

Është shumë e rëndësishme që negociatat midis huamarrësit dhe huadhënësit të zhvillohen në mirëbesim dhe të jenë të drejta dhe transparente. Të drejtat dhe detyrimet e palëve duhet të kryhen në mirëbesim, duke marrë parasysh interesat e palës tjetër. Qëllimi i parimit të mirëbesimit është krijimi i besimit dhe ndershmërisë gjatë procesit të ristrukturimit të kredisë midis palëve.

Është po aq e rëndësishme të theksohet se ristrukturimi i kredisë është i mundur vetëm nëse huamarrësi dhe huadhënësi punojnë së bashku për të arritur të njëjtin qëllim – i cili është për të mirën e palëve në afat të gjatë. Nëse njëra nga palët humb besimin e palës tjetër, atëherë ristrukturimi i kredisë mund të mos rezultojë i suksesshëm. Në këtë mënyrë, huadhënësit do të shfrytëzojnë të drejtat e dhëna atyre me ligj për të ndërmarrë masa ligjore për shkelje të detyrimeve kontraktuale.

PARIMI 3 PËRQASJA E UNIFIKUAR

Në rastet që përfshijnë më shumë se një huadhënës, interesat e huadhënësve përkatës mund të marrin në konsideratë një qasje të koordinuar për zgjidhjen e problematikave. Huadhënësit mund të lehtësojnë koordinimin e çështjeve duke formuar një komitet për të koordinuar punën midis tyre. Në varësi të madhësisë së borxhit dhe të kompleksitetit të çështjeve, huadhënësit më të rëndësishëm mund të zgjedhin të caktojnë këshilltarë profesionalë për të këshilluar dhe ndihmuar komitetin dhe huadhënësit e rëndësishëm.

Koment:

Ky parim gjen zbatim në rastet kur një huamarrës ka detyrime kontraktuale ndaj më shumë se një huadhënësi. Kjo gjë mund të krijojë vështirësi për arritjen e një zgjidhjeje në mungesë të një qëndrimi të unifikuar kundrejt huamarrësit. Sapo arrihet marrëveshja për ristrukturimin e kredisë (shih Parimin 5), huamarrësit kanë aftësinë të hyjnë në negociata me secilin prej huadhënësve, të cilët zakonisht përpiqen të sigurojnë që huamarrësi po trajtohet në mënyrë të barabartë edhe nga huadhënësit e tjerë.

Një ristrukturim kredie i suksesshëm është i mundur atëherë kur huadhënësit bashkëpunojnë për të arritur interesat e përbashkëta. Në mënyrë që të krijohet një qasje e unifikuar dhe një komunikim më efektiv, në rastin e ristrukturimit të kredisë, huadhënësit mund të formojnë një grup koordinues për të kryer negociatat, të vlerësojnë propozimet dhe të arrijnë një marrëveshje me huamarrësin për një zgjidhje përfundimtare.

Ka disa faktorë që ndikojnë në formimin e një grupi koordinues, të cilët përfshijnë madhësinë e huadhënësit, numrin e huadhënësve, interesat e tyre etj. Marrëveshja për krijimin e një grupi koordinues është zgjedhje e huadhënësve, të cilët mund të përcaktojnë mënyrën e përzgjedhjes së anëtarëve dhe atë të vendimarrjes.

Grupi koordinues ose huadhënësit më të rëndësishëm mund të zgjedhin një nga anëtarët e tyre si koordinatorin kryesor, i cili do të kryesojë mbledhjet e grupit koordinues dhe do të jetë përgjegjës për administrimin e procesit të ristrukturimit. Bashkëkoordinatorët nuk përfaqësojnë huadhënës të rëndësishëm në kuptimin e të pasurit autoritet për t'i orientuar ata në një drejtim të caktuar veprimi. Përkundrazi, ata lehtësojnë procesin e negociatave dhe shpërndarjen e informacionit për të gjithë huadhënësit. Gjithashtu, ata ndihmojnë në zgjidhjen e padive apo mosmarrëveshjeve, duke lehtësuar diskutimet midis huadhënësve përkatës.

Komiteti koordinues i mundëson huamarrësit një tregues të reagimit të mundshëm të huadhënësve përkatës mbi zhvillimet dhe propozimet që janë shtruar për zgjidhje. Është e rëndësishme që koordinatorët të sigurojnë që informacioni që marrin, të shpërndahet për të gjithë huadhënësit përkatës. Në parim, ata nuk kanë asnjë detyrim ose përgjegjësi ndaj huadhënësve të tjerë përkatës, qoftë shprehimisht apo në ndonjë mënyrë tjetër.

Të gjitha palët duhet të kenë parasysh se roli i koordinatorit dhe i grupit koordinues është që të lehtësojë procesin dhe jo të marrë vendime në emër të huadhënësve. Huadhënësit duhet të bëjnë vetë vlerësimin e tyre të pavarur dhe të marrin vendime në lidhje me çdo informacion, këshillë ose propozim që marrin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet koordinatorëve, duke mbajtur në vëmendje peshën që kanë në kredinë e dhënë si dhe duke mos çenuar interesat e huadhënësve të tjerë.

Nëse gjykohet e përshtatshme, huadhënësit duhet të diskutojnë dhe të miratojnë angazhimin e këshilltarëve profesionalë të tillë si avokatë, kontabilistë dhe vlerësues. Këta këshilltarë duhet të kenë përvojën dhe aftësinë e duhur për të dhënë këshilla të paanshme për të mirën e të gjithë huadhënësve përkatës.

PARIMI 4 NEGOCIMI ME HUAMARRËSIN

Huadhënësit caktojnë zakonisht një person (me përvojë në negociimin e ristrukturimit të kredive), i cili do të kryejë negociatën me huamarrësin dhe të transmetojë tek huadhënësit informacionin e dhënë nga huamarrësi.

Koment:

Për të rritur efektivitetin e procesit të ristrukturimit të kredisë dhe për të inkurajuar arritjen e një rezultati pozitiv, është e nevojshme autorizimi i një përfaqësuesi të huadhënësve (pjesë e grupit koordinues ose jo), i cili të mund të administrojë procesin negociues, të koordinojë informacionin me huadhënësit dhe të ndihmojë në zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje midis huadhënësve në lidhje me çështjet që ndikojnë në interesat e tyre. Kjo mënyrë mundëson një koordinim efikas të pozicionit të huadhënësve dhe mbron interesat e tyre. Huadhënësit mund të bien dakord të caktojnë më shumë se një koordinator që mund të përfaqësojnë interesat e tyre në negociatat me huamarrësin. Në çdo rast, numri i koordinatorëve nuk duhet të jetë më shumë se tre persona.

Zakonisht, koordinatorët nuk përcaktojnë orientimin e huadhënësve, por bëjnë gjithçka në drejtim të lehtësimit të procesit të negociatave dhe sigurimin e informacionit të nevojshëm për të gjithë anëtarët e grupit të koordinimit.

Nëse negociatat nuk japin rezultat, huadhënësit mund të zgjedhin të zhvillojnë negociata individuale me huamarrësin. Në këtë rast, do të ishte e vlefshme që huadhënësit të shkëmbejnë informacionin me njëri-tjetrin mbi procesin e negociimit dhe rezultatet e arritura për të ruajtur transparencën në marrëdhëniet reciproke.

Pa u kufizuar në zgjidhjet e mëposhtme, procesi i ristrukturimit mund të marrë parasysh një apo më shumë nga këto zgjidhje:

- a) Zgjatjen e afatit të kredisë;
- b) Ndryshimin e normës së interesit;
- c) Ndryshimin e këstit të kredisë;
- d) Ndryshimin e frekuencës së ripagimit të këstit;
- e) Kapitalizimin e interesit dhe/ose kësteve në vonesë;
- f) Dhënien e një periudhe faljeje (*grace*) për principalin ose interesin;
- g) Ndryshimin e produktit të kredisë;
- h) Rifinancimin e huamarrësit;
- i) Marrjen e kolateralit shtesë ose ndryshimin e kolateralit aktual me një tjetër me vlerë më të madhe;
- j) Transferimin e kredisë tek një huamarrës tjetër.

PARIMI 5 PERIUDHA E MORATORIUMIT

Gjatë procesit të ristrukturimit, vendoset një periudhë moratoriumi, zakonisht jo më shumë se 6 (gjashtë) muaj, gjatë së cilës ndodhin negociatat për gjetjen e formës së ristrukturimit. Kjo periudhë u shërben palëve për shkëmbimin e nevojshëm të informacionit, si dhe për të vlerësuar mundësitë e ofruara nga palët për gjetjen e një zgjidhjeje të pranueshme. Huadhënësit mund të zgjedhin të vendosin lehtësira kundrejt huamarrësve për shlyerjen e detyrimeve të tyre gjatë kësaj periudhe. Gjithsesi, një gjë e tillë nuk shfaqet si një e drejtë e huamarrësit, por një lehtësim i dhënë nga huadhënësit të cilët mbartin edhe kostot përkatëse. Detyrimet e huamarrësit vijojnë të përllogariten edhe gjatë periudhës së moratoriumit.

Koment:

Kohëzgjatja e periudhës së moratoriumit përcaktohet me marrëveshje ndërmjet huamarrësit dhe huadhënësve. Zakonisht, periudha e moratoriumit fillon në datën që huamarrësi bie dakord që të hyjë në negociata ristrukturimi me një afat prej jo më shumë se 6 (gjashtë) muaj, por në çdo rast ajo mund të ndryshojë në varësi të shumës së kredisë, të kompleksitetit, të informacionit që duhet grumbulluar, si dhe të kohës së nevojshme për të vlerësuar propozimet.

Marrëveshja midis huadhënësve për të hyrë në negociata ristrukturimi duhet të përfshihet në një akt marrëveshjeje ndërmjet huadhënësve dhe huamarrësve sipas të cilës:

- huamarrësi deklaron se nuk ka aftësi paguese dhe pranon shumën ligjore të kredisë së mbetur, duke përfshirë interesin, gjobat dhe pagesa të tjera;
- periudha e moratoriumit është vendosur në mënyrë të qartë;
- huadhënësit dhe huamarrësit mund të bien dakord për të bërë një ristrukturim sipas kushteve të këtyre parimeve;
- huadhënësit bien dakord të mos ndërmarrin masa ligjore për pretendimet e tyre dhe huamarrësi bie dakord të sigurojë një informacion të plotë në mbështetje të kërkesës së tij për të ristrukturuar kredinë.

PARIMI 6 GJETJA E BURIMEVE TË REJA

Megjithëse nuk është praktikë e zakonshme bankare të rritet ekspozimi i huamarrësit në rast të mosshlyerjes së rregullt të kredisë, gjatë procesit të ristrukturimit, huadhënësit mund të vendosin të mbështesin huamarrësin me burime të reja financimi, për të siguruar vijueshmërinë e veprimtarisë së biznesit dhe shlyerjen e detyrimeve të kredisë, duke marrë garancitë e nevojshme.

Koment:

Edhe pse nuk është zgjidhja më e mirë e mundshme, mbështetja e huamarrësit me burime shtesë financimi mbetet një rregull i rëndësishëm i ristrukturimit të kredisë.

Gjatë moratoriumit ose gjatë ristrukturimit të kredisë, huamarrësi mund të kërkojë burime financiare shtesë. Por për këtë, huamarrësi duhet të argumentojë nevojën për fonde, mënyrën e përdorimit dhe të pagimit të tyre.

Dihet se një parim themelor i ristrukturimit të kredisë është zvogëlimi dhe jo rritja e ekspozimit të huadhënësit ndaj një huamarrësi problematik. Megjithatë, duke marrë parasysh nevojën për të rindërtuar veprimtarinë ekonomike, nëpërmjet rehabilitimit dhe jo likuidimit të kompanive të qëndrueshme, si dhe faktit se procesi i ristrukturimit është fakultativ, huadhënësit mund të konsiderojnë financimin e mëtejshëm të huamarrësit duke marrë garancitë përkatëse. Huamarrësi duhet të përgatitet të njohë detyrimin shtesë nëpërmjet ofrimit të garancive apo kolateraleve shtesë nëse kërkohet nga huadhënësit. Gjithashtu, huamarrësi duhet të marrë parasysh se në qoftë se nuk ka pasuri që mund të përdorë si kolateral për fonde shtesë, ekziston rreziku që huadhënësit të mos ofrojnë kredi shtesë.

PARIMI 7 NDËRMARRJA E VEPRIMEVE GJATË PERIUDHËS SË MORATORIUMIT

Huadhënësit, rast pas rasti, angazhohen të rishikojnë vazhdimin ose jo të procedurave gjyqësore ose përmbarimore kundrejt huamarrësit dhe/ose të ndryshojnë ose jo pretendimet e tyre gjatë periudhës së moratoriumit. Në çdo rast, qëndrimi i huadhënësve duhet të parashikohet në marrëveshjen e nënshkruar për zhvillimin e negociatave.

Koment:

Ky parim rrjedh nga premisa bazë e këtij udhëzuesi, i cili përbën themelin e procesit të ristrukturimit të kredisë, ndërkohë që procesi është aprovuar reciprokisht në një marrëdhënie kontraktuale. Si rrjedhojë, ky parim mund të zbatohet vetëm nëse palët bien dakord. Siç u përmend edhe më lart, në një marrëveshje në periudhë moratoriumi, huadhënësit mund të bien dakord të mos ndërmarrin masa ligjore për pretendimet e tyre në mënyrë që t'i japin mundësi huamarrësit të krijojë një plan ristrukturimi. Baza për planin e ristrukturimit është dëshira e huadhënësit për të ndihmuar huamarrësin, për një përfitim afatgjatë.

Duke pasur parasysh këtë, në qoftë se huadhënësit besojnë se është e dobishme për huamarrësin të vazhdojë biznesin e tij, ata mund të krijojnë kushtet e nevojshme për funksionimin normal të biznesit të huamarrësit gjatë periudhës së moratoriumit. Kur arrihet një marrëveshje e tillë, huadhënësit mund të bien dakord të:

- lehtësojnë shlyerjen e kredisë gjatë periudhës së moratoriumit;
- mos fillojnë procedurat e falimentimit kundrejt huamarrësve gjatë periudhës së moratoriumit;
- mos përpiqen të përmirësojnë pozitën e tyre kundrejt huadhënësve të tjerë duke kërkuar garanci të reja ose privilegje gjatë periudhës së moratoriumit; dhe
- lejojnë huamarrësin të përdorë kredinë dhe shërbimet ekzistuese.

Huamarrësi duhet të marrë parasysh se kur nis një marrëveshje për periudhën e moratoriumit, duhet gjithashtu të bëjë premtime të caktuara në përputhje me parimet 8 dhe 9.

PARIMI 8 PREMTIMET E HUAMARRËSIT PËR HUADHËNËSIT GJATË PERIUDHËS SË MORATORIUMIT

Gjatë periudhës së moratoriumit, huamarrësi premtonte të mos ndërmarrë asnjë veprim që mund të ndikojë negativisht në ripagimin e kredisë kundrejt huadhënësve (për të gjithë huadhënësit apo ndonjërin prej tyre individualisht).

Kjo gjë duhet të parashikohet në marrëveshjen e nënshkruar për zhvillimin e negociatave.

Koment:

Ky parim, së bashku me parimin e mëparshëm, buron nga premisa bazë e udhëzimeve, i cili shpreh se ristrukturimi është një marrëveshje reciproke mbi marrëdhëniet kontraktuale. Nëse një marrëveshje ndërmjet palëve përbën bazën për periudhën e moratoriumit, atëherë veprimet e ndërmarra nga huamarrësi, që mund të shkaktojnë humbje huadhënësve, mund të përbëjnë bazën për ndërprerjen e marrëveshjes dhe rrjedhimisht kërkesën për shlyerjen e kredisë. Është shumë e rëndësishme që gjatë kësaj periudhe, huamarrësi të mos ndërmarrë asnjë veprim që mund t'i shkaktojë një ose disa huadhënësve një situatë më të vështirë sesa ajo përpara periudhës së moratoriumit. Gjithashtu, huamarrësi nuk duhet t'i japë përparësi një huadhënësi në lidhje me të tjerët.

PARIMI 9 TRANSPARENÇA E PLOTË E HUAMARRËSIT GJATË PERIUdhËS SË MORATORIUMIT DHE MARRËDHËNIEVE TË REJA KONTRAKTUALE

Në çdo kohë, huamarrësi do t'i sigurojë huadhënësve dhe përfaqësuesve të tyre të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me gjendjen financiare dhe parashikimet e bëra.

Koment:

Nëse baza e periudhës së moratoriumit është marrëveshja reciproke dhe nëse huamarrësi nuk është transparent në marrëdhëniet me huadhënësin, mund të ndikojë në prishjen e marrëveshjes nga ana e huadhënësit dhe kërkesën për ripagimin e kredisë.

Gjatë periudhës së ristrukturimit të kredisë, huadhënësit mund të vendosin kërkesa të rrepta transparence për huamarrësin. Nga ana tjetër, huamarrësi duhet të jetë i përgatitur të vërë në dispozicion të huadhënësit të gjithë informacionin mbi të gjitha pasqyrat financiare të kompanisë si dhe parashikimet e ardhshme të saj, të cilat i duhen huadhënësve për të vlerësuar situatën e huamarrësit. Kjo kërkesë duhet të pranohet nga ana e huamarrësit në mënyrë që huadhënësit të pranojnë të hyjnë në një marrëveshje për periudhën e moratoriumit.

Parimi i mirëbesimit (Parimi 2) vlen edhe për transparencën e huamarrësit.

PARIMI 10 KONFIDENCIALITETI I INFORMACIONIT

Nëse informacioni është i kufizuar për publikun, huadhënësit duhet të sigurojnë fshehtësinë e informacionit mbi gjendjen financiare të marrë nga huamarrësi, parashikimet dhe propozimet për zgjidhjen e problemeve që u vihen në dispozicion huadhënësve.

Koment:

Gjatë procesit të ristrukturimit të kredisë, huadhënësit do të marrin informacionin e duhur mbi gjendjen financiare dhe parashikimet e huamarrësit. Ndërkohë, huamarrësit duhet t'i japin huadhënësve të gjithë informacionin e nevojshëm.

Për këtë arsye, huamarrësi duhet të sigurohet se informacioni i dhënë do të trajtohet tërësisht si konfidencial, duke kërkuar aplikimin e rregullave të veçanta që të sigurohet për fshehtësinë e informacionit të tij.

PARIMI 11 NDËRTIMI I PLANIT TË RISTRUKTURIMIT TË KREDISË

Ndërtimi i një plani të përshtatshëm të ristrukturimit të kredisë është rezultati më i rëndësishëm i negociatave ndërmjet huadhënësve dhe huamarrësit. Për ndërtimin e këtij plani është shumë i rëndësishëm shkëmbimi i informacioneve dhe propozimeve për gjetjen e një zgjidhjeje të pranueshme për shlyerjen e kredisë.

Koment:

Huamarrësi mund të paraqesë propozime për ristrukturimin e kredisë, të cilat duhet të jenë të bazuara në një plan biznesi dhe të përmbajnë informacion në lidhje me hapat e nevojshëm që duhet të ndërmerren për të zgjidhur problemet financiare të tij. Planin e biznesit duhet të bazohet në parashikime të shëndosha dhe të realizueshme, ku pasqyrohet aftësia e huamarrësit për të rritur flukset e parasë në nivel të nevojshëm për ekzekutimin e planit të ristrukturimit të kredisë (dhe jo thjesht të vonojë procesin e falimentimit).

Qëllimi i periudhës së moratoriumit është ofrimi i mundësisë që huamarrësi të përgatisë një plan ristrukturimi. Planin duhet të vërtetojë që kompania do të jetë fitimprurëse, si dhe të përcaktojë shumën që huamarrësi do të jetë në gjendje të paguajë për secilin huadhënës. Nga ana tjetër, huadhënësit mund të ndihmojnë huamarrësin në hartimin e planit të ristrukturimit.

Është e pamundur të krijohet një model standard për ristrukturimin e kredive, sepse siç u përmend më parë, ristrukturimi është i bazuar në

vullnetin e lirë të palëve. Duke pasur parasysh këtë, plani mund të përmbajë zgjedhjen e huadhënësit dhe të huamarrësit të koncepteve të Kodit Civil për të hyrë në një kontratë, si dhe ndryshimin apo anulimin e tij. Megjithatë, duhet theksuar se huadhënësit nuk do të mbështesin një plan i cili:

- nuk përmban një parashikim mbi fitimet/humbjet mujore dhe /ose tremujore dhe/ose vjetore të biznesit (për shembull, për pesë vitet e ardhshme);
- nuk përmban një parashikim të flukseve të parasë, duke përfshirë pagesat për huadhënësit (për shembull, për tre vitet e ardhshme);
- nuk përmban burime prej të cilave kapitali qarkullues do të përthithet, si dhe mënyrën e financimit të përmirësimeve të mundshme në drejtim të efikasitetit financiar;
- nuk identifikon se si ndryshimet e propozuara (për shembull, shtrirja e ripagimit të kredisë ose vendosja e periudhës së faljes (*grace*) së kredisë) do të ndikojnë në të drejtat e huadhënësve;
- nuk përmend ndryshimet më të rëndësishme në biznesin e huamarrësit brenda kësaj periudhe kohore;
- nuk identifikon supozimet mbi të cilat janë bazuar parashikimet.

Në qoftë se huamarrësi nuk arrin të bindë huadhënësit mbi aftësinë e tij për të zgjidhur problemet financiare brenda një periudhe afatmesme, atëherë me shumë mundësi huadhënësit nuk do të pranojnë ristrukturimin e kredisë.

PARIMI 12 PROPOZIMET E BËRA KORRESPONDOJNË ME TË DREJTAT E PALËVE

Kur bëhen propozime për zgjidhjen e vështirësive financiare të huamarrësit, palët duhet të kenë parasysh të drejtat e çdo huadhënësi dhe shumën e detyrimeve të papaguara në datën e fillimit të periudhës së moratoriumit, pa përjashtuar detyrime të tjera që mund të lindin më vonë.

Koment:

Gjatë kohës ndërmjet datës së fillimit të periudhës së moratoriumit dhe datës së marrëveshjes mbi planin e ristrukturimit të kredisë, huadhënësit duhet të bien dakord se marrëdhënia me njëri-tjetrin nuk do të ndryshojë. Gjithashtu, huamarrësi nuk mund të supozojë që huadhënësit më të rëndësishëm, të cilët mund të kenë më shumë garanci, do të bien dakord për një propozim ristrukturimi në qoftë se pozicioni i tyre përkeqësohet në lidhje me huadhënësit që nuk kanë garanci të mjaftueshme.

.....

BANKA E SHQIPËRISË

www.bankofalbania.org

Sheshi "Avni Rustemi", Nr. 24, Tiranë, Shqipëri
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419409/10/11
Faks: + 355 4 2419408
public@bankofalbania.org